

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore

Viti 2019

Tiranë, më 02 Korrik 2020: Në vitin 2019, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore (2015=100) arriti në 104,0 nga 101,2 që ishte në 2018. Ky indeks shënoi një rritje me 2,7 %, krahasuar me një vit më parë. Krahasuar me një vit më parë, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje me 3,0 % dhe indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale shënoi rritje me 2,4 %. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten vlerat e indeksit të çmimeve të “Prodhimeve Bimore”, “Prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale” dhe “Prodhime bujqësore gjithsej”, sipas tremujorëve të periudhës 2016 - 2019.

Fig. 1 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100)



Ndryshimet vjetore të çmimeve sipas grupeve kryesore:

Rritjen më të madhe vjetore e kanë shënuar çmimet e grupit “Patate” me 49,0 %, pasuar nga çmimet e grupit “Qumësht dhe produkte të tjera blegtoriale” me 2,8 %. Çmimet e grupit “Mish peshë e gjallë” u rritën me 1,8 %, çmimet e grupit “Bimë Industriale” me 1,3 %, çmimet e grupit “Drufrutorët” me 2,1 % dhe çmimet e grupit “Perime” me 0,7 %. Çmimet e grupit “Bimë foragjere” kanë shënuar rënien më të madhe me 4,6 %, ndërsa çmimet e grupit “Drihtëra” shënuan një rënie prej 3,6 %.

Tab. 1 Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100)

Produktet	Peshanë %	2015 Viti bazë	2016		2017		2018		2019	
			Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor
Prodhime Bujqësore Gjithsej	100	100	99,9	-0,1%	99,2	-0,7%	101,2	2,0%	104,0	2,7%
Drihtëra	4,2	100	100,3	0,3%	88,7	-11,6%	87,9	-1,0%	84,7	-3,6%
Bimë Industriale	0,4	100	102,1	2,1%	124,4	21,8%	133,9	7,7%	135,7	1,3%
Bimë foragjere	3,8	100	102,1	2,1%	95,1	-6,9%	88,6	-6,8%	84,6	-4,6%
Perime	23,2	100	98,2	-1,8%	98,3	0,0%	107,2	9,1%	108,2	0,9%
Patate	3,1	100	106,1	6,1%	97,7	-7,9%	94,1	-3,7%	140,1	49,0%
Prodhimet e drufrutorëve	17,2	100	99,4	-0,6%	99,7	0,2%	99,9	0,2%	101,2	1,4%
Fruta	8,2	100	105,8	5,8%	106,7	0,9%	106,3	-0,4%	102,2	-3,8%
Agrume	1,0	100	98,1	-1,9%	100,8	2,8%	99,7	-1,1%	89,6	-10,1%
Rrush	5,5	100	99,9	-0,1%	96,3	-3,6%	97,8	1,6%	103,0	5,4%
Ullinj	2,5	100	77,9	-22,2%	83,3	7,0%	83,4	0,1%	98,7	18,3%
Verë	2,6	100	108,0	8,0%	122,5	13,5%	127,2	3,8%	131,1	3,1%
Vaj Ulliri	1,5	100	102,0	2,0%	100,0	-1,9%	104,5	4,5%	104,9	0,4%
Prodhimet bimore	56,0	100	100,0	0,0%	99,1	-0,9%	102,6	3,5%	105,7	3,0%
Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	100	99,5	-0,5%	102,2	2,7%	103,2	1,0%	105,0	1,8%
Gjedhi	8,3	100	99,9	-0,1%	101,0	1,1%	101,6	0,6%	102,2	0,6%
Derra	3,1	100	101,8	1,8%	107,1	5,2%	106,7	-0,3%	107,5	0,7%
Të imta	5,1	100	97,2	-2,8%	101,5	4,4%	105,0	3,5%	108,8	3,7%
Shpendë	2,1	100	100,2	0,2%	101,4	1,2%	100,3	-1,0%	103,5	3,2%
Qumësht	19,7	100	101,3	1,3%	97,6	-3,7%	96,9	-0,7%	99,7	2,9%
Qumësht lope	14,8	100	99,4	-0,6%	97,5	-1,9%	97,2	-0,3%	100,1	3,0%
Qumësht të tjerë	4,9	100	107,0	7,0%	97,7	-8,7%	96,1	-1,7%	98,3	2,4%
Produkte të tjera blegtoriale	5,7	100	95,0	-5,0%	96,3	1,4%	96,6	0,3%	99,2	2,7%
Veze	2,8	100	89,5	-10,5%	99,2	10,7%	97,5	-1,6%	102,4	5,0%
Mjalt	2,9	100	99,8	-0,2%	93,2	-6,7%	95,2	2,2%	96,2	1,0%
Prodhimet e blegtorisë dhe produkte të tjera blegtoriale	44,0	100	99,7	-0,3%	99,3	-0,4%	99,5	0,2%	101,9	2,4%

Tab. 2 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, 2017 (2015=100)

Kodi	Produktet	Pesha në %	Tremujori I 2017		Tremujori II 2017		Tremujori III 2017		Tremujori IV 2017	
			Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor
	Total Prodhime Bujqësore	100	107	2,6%	103,8	-0,5%	90,8	-5,2%	98,2	1,7%
1	Dritëra	4,2	91,8	-10,7%	91,1	-14,5%	86	-13,5%	86,8	-6,9%
2	Bimë Industriale	0,4	125,2	25,7%	122,3	27,7%	122,3	23,0%	126,9	13,7%
3	Bimë foragjere	3,8	106,7	-1,7%	97,4	-6,9%	90,9	-8,0%	88,9	-10,2%
4	Perime	23,2	127,7	12,2%	109,1	3,5%	70,6	-14,9%	89,3	-2,7%
5	Patate	3,1	103,9	1,0%	104,3	-16,7%	90,1	-3,8%	88,8	-1,4%
6	Prodhimet e drufutorëve	17,2	101,5	-1,2%	108,7	-5,5%	93,6	-4,3%	100,6	10,7%
6.1	Fruta	8,2	105,3	7,8%	109,9	-7,1%	99,4	-0,3%	111,8	16,6%
6.2	Agrume	1	102,3	-15,2%	-	-	-	-	100	15,9%
6.3	Rrush	5,5	-	-	-	-	89,9	-8,1%	111,6	6,4%
6.4	Ullinj	2,5	85,8	-11,9%	96,6	17,4%	95,6	23,2%	78,9	6,3%
7	Verë	2,6	119,9	4,4%	119,6	8,3%	123,4	6,7%	124,7	32,2%
8	Vaj Ulliri	1,5	100,3	-3,1%	97,6	-7,1%	96,8	-7,1%	103,4	5,7%
	Prodhimet bimore	56	114	4,8%	107,5	-1,5%	86,1	-7,9%	96,4	4,1%
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	102	2,0%	101,5	3,2%	101,4	2,1%	103,6	3,2%
9.1	Gjedhi	8,3	100,7	-0,2%	100,3	0,4%	101,2	1,9%	101,8	2,0%
9.2	Derra	3,1	106	7,5%	108,2	8,6%	107,4	2,9%	106,7	2,2%
9.3	Të imta	5,1	100,5	-0,2%	98,7	3,8%	99,4	4,1%	105,7	7,6%
9.4	Shpendë	2,1	103,9	6,5%	103,5	4,7%	98	-2,6%	100,2	-3,4%
10	Qumësht	19,7	98,6	-3,6%	98,4	-1,8%	96	-4,4%	97,5	-5,4%
10.1	Qumësht lope	14,8	97,9	-1,8%	99	0,2%	96,1	-3,2%	96,9	-3,1%
10.2	Qumësht të tjerë	4,9	101,8	-9,7%	96,7	-7,0%	95,7	-7,5%	99,6	-12,2%
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	99,4	6,3%	94,6	5,8%	92,7	-1,1%	98,7	-4,5%
11.1	Vezë	2,8	103,9	19,7%	98,7	24,8%	92	6,0%	102,1	-3,2%
11.2	Mjalt	2,9	94,7	-4,7%	90,6	-8,1%	92,6	-7,6%	94,7	-6,3%
	Prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale	44	100,3	0,4%	99,1	0,8%	97,7	-1,4%	100,6	-1,2%

(-) Produkte sezonale

Tab. 3 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, 2018 (2015=100)

Kodi	Produktet	Pesha në %	Tremujori I 2018		Tremujori II 2018		Tremujori III 2018		Tremujori IV 2018	
			Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor
	Total Prodhime Bujqësore	100	105,2	-1,7%	103,7	-0,1%	96,5	6,3%	101	2,9%
1	Dritëra	4,2	91,9	0,1%	92,6	1,6%	84,6	-1,6%	83,6	-3,7%
2	Bimë Industriale	0,4	137,5	9,8%	134,4	9,9%	131,7	7,7%	132	4,0%
3	Bimë foragjere	3,8	98	-8,2%	97,3	-0,1%	84,3	-7,3%	80,6	-9,3%
4	Perime	23,2	116,5	-8,8%	110,1	0,9%	94	33,1%	111,7	25,1%
5	Patate	3,1	80,5	-22,5%	86,9	-16,7%	96,5	7,1%	114,8	29,3%
6	Prodhimet e drufutorëve	17,2	125	23,2%	110,3	1,5%	93,7	0,1%	93,6	-7,0%
6.1	Fruta	8,2	132,3	25,6%	111	1,0%	97	-2,4%	95,9	-14,2%
6.2	Agrume	1	120,6	17,9%	-	-	-	-	88,7	-
6.3	Rrush	5,5	-	-	-	-	91,5	-	112,7	-
6.4	Ullinj	2,5	102,6	19,6%	103,9	7,6%	97,3	1,8%	75	-4,9%
7	Verë	2,6	122,6	2,3%	130,2	8,9%	128,4	4,1%	125,4	0,6%
8	Vaj Ulliri	1,5	104,7	4,4%	104,8	7,4%	104	7,4%	104,7	1,3%
	Prodhimet bimore	56	110,8	-2,8%	107,7	0,2%	94,9	10,2%	101	4,8%
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	103,3	1,3%	102,7	1,2%	102,7	1,3%	104	0,4%
9.1	Gjedhi	8,3	102	1,3%	101,2	0,9%	101,2	0,0%	101,9	0,1%
9.2	Derra	3,1	107,2	1,1%	106,4	-1,7%	106,2	-1,1%	107,2	0,5%
9.3	Të imta	5,1	106,3	5,8%	104,1	5,5%	104,5	5,1%	105,3	-0,4%
9.4	Shpendë	2,1	98,0	-5,7%	99,8	-3,6%	99,8	1,8%	103,7	3,5%
10	Qumësht	19,7	96,9	-1,7%	96,8	-1,6%	96,8	0,8%	97,2	-0,3%
10.1	Qumësht lope	14,8	97,5	-0,4%	97,1	-1,9%	96,7	0,6%	97,4	0,5%
10.2	Qumësht të tjerë	4,9	94,3	-7,4%	95,9	-0,8%	96,9	1,3%	96,5	-3,1%
11	Produkte të tjera blegtorale	5,7	97	-2,4%	93,2	-1,5%	94,9	2,4%	101,4	2,7%
11.1	Veze	2,8	98,6	-5,1%	90,3	-8,5%	94,2	2,4%	107	4,8%
11.1	Mjalt	2,9	94,8	0,1%	95	4,9%	95	2,6%	96	1,4%
	Prodhimet e blegtorisë dhe produkteve të tjera blegtorale	44,0	99,8	-0,5%	98,6	-0,5%	98,9	1,2%	101	0,4%

(-) Produkte sezonale

Tab. 4 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, 2019 (2015=100)

Kodi	Produktet	Pesha ne %	Tremujori I 2019		Tremujori II 2019		Tremujori III 2019		Tremujori IV 2019	
			Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor	Indeksi	Ndryshimi vjetor
	Total Prodhime Bujqësore	100	113,9	8,3%	107,5	3,7%	96,8	0,3%	101,3	0,3%
1	Drithëra	4,2	86,1	-6,3%	86,1	-7,0%	84	-0,7%	82,7	-1,1%
2	Bimë Industriale	0,4	139,3	1,3%	138,8	3,3%	134,6	2,2%	130,8	-0,9%
3	Bimë foragjere	3,8	86,2	-12,0%	83,1	-14,6%	84,8	0,6%	83,9	4,1%
4	Perime	23,2	153,2	31,5%	112,5	2,2%	85,3	-9,3%	90	-19,4%
5	Patate	3,1	166,7	107,1%	168,5	93,9%	108,9	12,8%	101,1	-11,9%
6	Prodhimet e drufrutorëve	17,2	94,6	-24,3%	106,7	-3,3%	97,7	4,3%	104,3	11,4%
6.1	Fruta	8,2	100,8	-23,8%	106,7	-3,9%	98,4	1,4%	101,8	6,2%
6.2	Agrume	1	69,2	-42,6%	-	-	-	-	100,2	-
6.3	Rrush	5,5	-	-	-	-	96,6	-	118,4	-
6.4	Ullinj	2,5	105,6	2,9%	106,1	2,1%	109,9	12,9%	94,8	26,4%
7	Verë	2,6	129,9	6,0%	136,9	5,1%	125,4	-2,3%	134,1	6,9%
8	Vaj Ulliri	1,5	105	0,3%	104,4	-0,4%	104,5	0,5%	105,4	0,7%
	Prodhimet bimore	56	127	14,6%	113,5	5,4%	93,6	-1,4%	98,6	-2,4%
9	Prodhim mishi peshë e gjallë	18,6	104,2	0,9%	104,3	1,6%	104,7	1,9%	106,7	2,6%
9.1	Gjedhi	8,3	102,2	0,2%	102,1	0,9%	102,1	0,9%	102,5	0,6%
9.2	Derra	3,1	107,4	0,2%	107,1	0,7%	107,4	1,1%	108,1	0,8%
9.3	Të imta	5,1	107,2	0,8%	107,1	2,9%	108,1	3,4%	111,6	6,0%
9.4	Shpendë	2,1	102,1	4,2%	102,4	2,6%	103	3,2%	106,7	2,9%
10	Qumësht	19,7	99	2,2%	97,5	0,7%	99,8	3,1%	103,3	6,3%
10.1	Qumësht lope	14,8	98,5	1,0%	98	0,9%	100,6	4,0%	103,9	6,7%
10.2	Qumësht të tjerë	4,9	100,8	6,9%	96,3	0,4%	97,6	0,7%	101,1	4,8%
11	Produkte të tjera blektorale	5,7	98,7	1,8%	97,1	4,2%	98,4	3,7%	102,6	1,2%
11.1	Vezë	2,8	102,7	4,2%	99,3	10,0%	99,4	5,5%	108	0,9%
11.1	Mjalt	2,9	94,8	0,0%	95	0,0%	97,4	2,5%	97,5	1,6%
	Prodhimet e blegtorisë dhe produkte të tjera blektorale	44	101,3	1,5%	100,1	1,5%	101,5	2,6%	104,8	3,8%

Metodologjia

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standartet dhe rregullat e përsukuara në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat. Çmimet mbledhen nga Anketa Mujore për Produktet Bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbledhja e të dhënave kryhet pranë fermave, tregjeve të gjësë së gjallë, tregjeve të shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen. Informacioni merret vetëm për çmimet në nivel ferme për produktet vendase, duke përjashtuar taksat. Ato janë llogaritur në Lek, kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë sipas produktit.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industriale, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për mishin peshë e gjallë dhe prodhimet blegtorale. Çmimet e mishit peshë e gjallë grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjaltë.

Skema e peshave në Indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore

Për llogaritjen e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore përdoret një skemë e mirëpërcaktuar peshash. Vlera e peshës bashkëngjitur në çdo indeks elementar dhe në indeksin e agreguar është e barabartë me vlerën e shitjes së produkteve (pa përfshirë TVSH) gjatë periudhës bazë (2015=100), bazuar kjo në metodologjinë ndërkombëtare. Peshat përdoren gjithashtu dhe për të bashkuar nëngrupet e indekseve në nivel grupi dhe për të agreguar indekset në nivel grupi duke prodhuar indeksin vjetor. Peshat e çmimeve të produkteve bujqësore janë konform parimeve të Llogarive Ekonomike në Bujqësi (në konceptin e çmimeve të prodhimit). Skema e peshave për Indeksin e Çmimeve Bujqësore ndryshon çdo 5 vite. Gjatë kësaj periudhe peshat totale dhe peshat tremujore të çmimeve të produkteve bujqësore nuk ndryshojnë.

Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Indeksi elementar llogaritet sipas formule në vijim duke përdorur çmimet mesatare absolute.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0}, 100$$

R_i^t : Indeksi elementar për muajin "t" dhe prodhimin "i"

P : Çmimet e grumbulluara

i : Prodhimi “i”

j : Çmimi i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për rrethin 1,2,...,n)

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve

Indeksi të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është llogaritur duke shfrytëzuar formulën në vijim:

$$I^t = \sum (R_i^t \cdot \frac{w_i^o}{\sum w_i^o}) \cdot 100$$

I : Indeksi i agreguar për periudhën “t”

w_i^o : Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin “i”

i : Prodhimi “i”

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë